



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10, datë 22.08.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁵)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Rajmonda Zoto | 20.Besmir Brahimi |
| 2.Edlira Kapllanaj | 21.Klodian Xhyheri |
| 3.Vullnet Bilbilaj | 22.Geron Gunbardhi |
| 4.Endri Hyseni | 23.Elca Bezhani |
| 5.Simbol Pazaj | 24.Marsela Dashi |
| 6.Frosina Qyrdeti | 25.Edison Kapaj |
| 7.Sokol Kushta | 26.Grigor Dede |
| 8.Brikena Sika | 27.Atird Hoxha |
| 9.Illir Aliaj | 28.Elpiniqi Mërkuri |
| 10.Jerina Dervishaj | 29.Ervis Moçka |
| 11.Simo Petromilo | 30.Englantina Imeraj |
| 12.Evis Allushi | 31.Briseida Çakërri |
| 13.Lorel Canaj | 32.Viola Xhafaj |
| 14.Eglantina Aliaj | 33.Aurora Qarri |
| 15.Ledja Shollaj | 34.Bujar Osmanaj |
| 16.Arsen Belaj | 35.Liljana Breshani |
| 17.Roland Strakosha | 36.Refie Laze |
| 18.Anisa Ceno | |
| 19.Brikena Puka | |

Mungojnë :

- 1.Ardian Musta
- 2.Shkëlqim Leskaj
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Mujo Shakaj
- 5.Eda Begaj
- 6.Arjan Isufi
- 7.Liri Dëma
- 8.Dikens Bushaj
- 9.Anxhela Shenaj
- 10.Erëmal Arapi
- 11.Gjergji Nika
- 12.Eneida Vera
- 13.Alta Haluci
- 14.Novrus Rrokaj
- 15.Myzafer Elezi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/1, datë 22.08.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës së datës 22 .08.2024. (Lexon) Shprehje e ligjshmërisë për VKB Nr 63-70, datë 30.07.2024, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, janë shprehur të ligjshëm. Vijojmë me miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së datës 27.06.2024.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 30.07.2024.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Ka ardhur një projektvendim shtesë, është urgjent .

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Për të ripërsëritur, në shkelje të Rregullores, Nenit 66..lexon., ku rendi i ditës, duhet të jetë me 10 pika...Rendi i ditës me objekt buxhet, konçension, etj mos të kalojë numrin 5 të projektakteve... Mendoj ta ndërpresim mbledhjen, të mblidhet Konferenca e Kryetarëve që të tërheqim pika të panevojshme, ose ato me konçension..... Në këtë rend dite kemi 15 pika,Ju thoni të shtojmë dhe një pikë tjetër. Pra, mendoj të mbledhemi, të heqim pesë pika.....nga ato me konçension...pra të heqim, ose ato...Ky është propozimi im, që mos ta bëjmë mbledhjen të pavlefshme.

Z.Ervis Moçka – Pra, s’dua të flas për pavlefshmëri . Jemi për problemet e qytetarëve.Administrata i ka sjellë projektvendimet, ku ka projektvendime me objekt të njëjtë. Pra, ato me ndryshime në VKB Nr 100, administrata le ti përmblihte në një.

Pra, mund të gjejmë një konsensus, mos ta bëjmë mbledhjen të pavlefshme. Mund të heqim emërtime rrugësh, prpozimet..., që s'janë shumë emergjente.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim rendin e ditës, me projektvendimn shtesë.

Le të mblidhet Kryetarët e Kryetarëve, dhe të vendosim.(mblidhet Konferenca e Kryetarëve)

Z.Ervis Moçka – Atëherë, nga diskutimi në Konferencën e Kryetarëve, propozuam që projektvendimet “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023, “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” të kalojnë në një projektvendim, janë me të njëjtin objekt dhe, projektvendimet e fundit, për emërtime rrugësh dhe propozime, ti kalojmë dhe ato,pasi janë në dobi të qytetarëve dhe figurave të qytetit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votë rendin e ditës, me projektvendimin shtesë.

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/2, datë 22.08.2024.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin korrik 2024”.

Pyetje, diskutime ? -Jo.

Votohet.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/3, datë 22.08.2024.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin korrik 2024”.

Votohet.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/4, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Shtyrje të Afatit të Kontratës për Administrimin dhe Financimin e Shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A”.

Ka ardhur dhe përfaqësuesi ligjor i klubit, zoti Bezhani. Kush e do fjalën ?

Z.Endri Hyseni – Përsa i përket këtij projektvendimi, ka ardhur si pasojë e kërkesës së Administratorit të Klubit të Futbollit “Flamurtari” dhe Shoqërive. Me iniciativën e një grupi këshilltarësh , prej 5 anëtarësh , kemi hartuar këtë projektvendim, bazuar në ligj, për shtyrjen e afatit të kontratës , për një periudhë 1-vjeçare. Proçesi i privatizimit ka filluar. Për ti hapur rrugën dhe klubit të futbollit, për rregjistrimin në lojrat e FSHF , pasi duhet të marrin pjesë në këto lojra. Po presim ndërkohë dhe raportin financiar të këtij klubi. Falenderues dhe për shoqëritë sponsorizuese.

Z. Sokol Kushta – Dua ta filloj me Ju zoti Kryetar dhe Kryetarët e grupeve. Janë këta këshilltarë që e kanë ndihmuar administratorin. Për atë Emblemë, që mburret gjithë qyteti i Vlorës. Përse, ky administrim është i dështuar...

Me letra afati është deri në 20 nëntor. Është e palejueshme që ky administrator të sjellë dokumentacionin në korrik, por të vinte që në muajin maj.

Të dimë, në çfarë momenti është shitja e aksioneve. Tani për dy vjet, sjell përsëri shtyrjen. Në të tre komponentët, ky administrim është i dështuar. Ka 4-5 vjet që, në ekip, nuk ka një vlonjat. Nuk është bërë asnjë diskutim. Asnjëherë nuk është mbledhur bordi dhe ka nxjerrë konkluzione.

Sot “Flamurtari “, ana sociale, është zero. Ana ekonomike...Zyra ekonomike e bashkisë, le të flasë. Administratori thotë, ka 4 milion euro borxh. Kam qenë i pari që, ky administrim të vazhdojë. E falenderoj për Klubin “Oriku” dhekur të vijë shitja e aksioneve të Flamurtarit. Mund të jetë zvogëluar si emër, por ne duhet të mburremi. Argumentat, pse duhet ta ndihmojmë këtë administrator . Them deri në nëntor ta lëmë , por Kryetari i Bashkisë me Zyrën Juridike të vazhdojnë procedurat. Kush mund të na argumentojë.

Z.Klodian Xhyheri – Ne vijmë prapë një vit më pas , për shtyrje kontrate. Mund ta shtyjmë pafund këtë kontratë , por duhet të kuptojmë që ky klub , që kur u morr në administrim nga ky administrator, nuk e ka më atë shkëlqim, rezultate skandaloze , por dhe të dhënat financiare, skandaloze.Nuk ia ka fajin asnjë këtij administratori , ka keq administrim. Nuk mendoj ta shtyjmë afatin.

“Flamurtari” vetëm bie nga kategoria. Jam kundër shtyrjes së kësaj kontrate, administrim i keq. Z.Sokol Kushta – Nuk jemi për bllokim të gjërave. Meqenëse zotëria mbaron në muajin nëntor dhe, nëqoftëse Kryetari i Bashkisë dhe Zyra Juridike, na premtojnë që, në muajin nëntor janë gati shitja, unë jam pro. Të lexojmë dokumentacionin.

Z.Ermal Dredha – Flas si administratë dhe komunitet vlonjat, të vazhdojë federimin skuadra , të marrë pjesë në kampionat . Administrata po merret me procedurat e privatizimit. Kam bërë disa premtime dhe po i mbajmë, po punojmë. Duam që skuadra të eci përpara. Shpenzime janë bërë pafund, nuk është objekt diskutimi. Të gjithë në logjikë, mendoj ta votojmë. Është në të mirë të Vlorës.

Z.Sokol Kushta – Në qytetet e tjera ka funksionuar. Bordi nuk është mbledhur asnjëherë. Ju zoti Kryetar, duhet të keni një informacion, sa u shit, sa u ble një lojtar. Ju s’keni asnjë përfaqësues , që të shihet çdo faturë. Ne duhet të japim një zgjidhje , që klubi duhet të punojë . pse e ka sjellë në muajin korrik, kur në muajin gusht fillojnë lojrat.

Dua të jem, pro “Flamurtarit “.

Znj.Evis Allushi – Ka ardhur koha për ta privatizuar “Flamurtarin “. Nuk mund të vazhdojmë më me shtyrje dhe hezitim për privatizim. Viti 2014, gusht 2014 – gusht 2024, janë 10 vite. Bashkia nuk ka paguar. Bashkia ka kursyer 10 miliard lekë. Duhet të jemi mirënjohës zotit Idrizi. Pra, sot duhet të kalojmë në procedurën e privatizimit. Bashkia Vlorë ka detyrë të fillojë procedurën e privatizimit të këtij klubi. Thjesht kemi patur shtyrje të afatit dhe jo procedurë në kuadrin ligjor, për privatizimin e këtij klubi. Një bashkëpunim i zotit Idrizi me bashkinë ... Nëqoftëse, zoti Idrizi e lë, i ngelen detyrimet bashkisë. Materiali sot me propozimin e pesë anëtarëve, nuk na ka ardhur në kuadrin ligjor për privatizim. Kam qenë Kryetare e Këshillit, në vitin 2014.

Doja të thosha dhe diçka, Ambjenti tek shkolla “Ali Demi “Kërkoj bashkëpunimin për një projektvendim që ai territor ti kalojë gjimnazit “Ali Demi “

Z.Dorian Demiri – Për nisjen e procedurave të privatizimit. E kemi filluar. Po mbledhim dokumentacionin. Për korrektësi..., mund të përfundojë deri në shtator.

Administrata, sot e ka procedurën gati.

Z.Grigor Dede – Ka nisur procedura e privatizimit të Klubit të Futbollit “Flamurtari “. Në lidhje me analizën ekonomiko – financiare , nuk janë objekt i këtij projektvendimi. Kjo analizë mund të bëhet mbas përfundimit të procedurës së privatizimit. Ne marrim një iniciativë për shtyrjen e kontratës. Pika 2..lexon...përfundon me shitjen ...Pra, kontrata përfundon me shitjen e aksioneve. Por ky ekip, duhet të hyjë në lojra...Pra, bëhet kjo shtyrje që, ky ekip të funksionojë rregullisht dhe ne duhet ta miratojmë.

Z.Arsen Belaj – Për shitjen e aksioneve të “Flamurtarit “, nuk jam dakort për një gjë. Kemi thënë për dy klubet ,”Flamurtarin “ dhe “Orikun”, do bëhen shitjet e aksioneve. Ky Klub “Oriku “, ka që në muajin gusht që ka mbledhur lojtarët , kanë lidhur kontrata deri në fund të vitit, Kush do ti paguajë këta lojtarë ? Nëqoftëse këta lojtarë e hedhin në gjyq bashkinë, kush e mban përgjegjësinë?

Propozoj që, që nga fundi i muajit korrik – dhjetor të paguhen nga bashkia, dhe deri sa të shitet përfundimisht Klubi i “Oriku”-t, duhet paguar. Këto dy shoqëri , që bashkëpunojnë me bashkinë, TRK ..kush është përfaqësues i tyre? Bashkia ka 3 milion euro borxh. Ka audit nga bashkia për këto klube?

Kush më garanton që, vitin që vjen, prapë s’na vjen kjo shtyrje .

Znj.Elca Bezhani – Ka procedura.

Z.Geron Gunbardhi – Më vjen mirë që ky këshillvjen me nxitim se ikën afati ...

Zoti Demiraj na dha informacion, na dha një sqarim.Duhet të kishim informacion se çfarë është bërë. Jemi të gjithë pjesë e këtij qyteti.Ky zotëria do falenderuar. Por, asnjëri nuk thotë që, pse asnjë nga fëmijët tanë të jetë në këtë klub. Të financojmë, por këta të jenë qytetarë nga Vlora, të rinjtë tanë. Pse ta bëjmë politike. Vota ime është pro.

Ne po humbim brezat e ardhshëm, rininë e Vlorës. Bashkia të investojë për ekipet e dyta, mos të largohen nga qyteti.

-Pyetje..Kryeministri tha se, do të bëhen tre stadione. Është i informacion i saktë?

Vota ime është pro, me kushtin për privatizimin e tij.

Z.Illir Aliaj – Në këtë pikë që ka arritur situata, jam dakort të shtyhet afati, të shtyhet kontrata . Nëqoftëse, do të ishte ndryshe, të gjitha borxhet do ti ngelen bashkisë. Unë them ti japim kohën e mjaftueshme për vlerësimin e aseteve,privatizimit, për marrjen pjesë në lojra, në federim, për këtë të shtyjme kontratën 1 vit.

Z. Rinald Bezhani /“Përfaqësues i KF”Flamurtari”- Me 90% tuaj, njihem. Erdha më tepër si vlonjat..Për mungesën e një transparence që ,klubit të futbollit i ka munguar. Ju jeni përfqësues të këtij komuniteti.Dua të falenderoj zotin Ermal Dredha.Zoti Idrizi, si fillim, u gjend para një kontrate me 80mijë euro, që duhet ti paguante një lojtari. (Flet për ecurinë, historikun e KF”Flamurtarit”)

Sportklubi , mbulohet me 18% nga Buxheti i Bashkisë., në tatime etj ..Për KF”Flamurtari “, zoti Idrizi harxhon. Është keq në të dhënat financiare.

Z.Klodian Xhyheri – Prandaj, zoti Sokol thotë që, duhet të ishte një person nga bashkia.

Z.Rinald Bezhani – Do ti kërkoja këshillit bashkiak për shtyrjen e afatit deri në momentin e privatizimit...Kush është shoqëria ...

Z.Atird Hoxha – Ritheksoj dhe njëherë, në lidhje me përfaqësuesin e TRG Group dhe Atlas Global,që në start dua shpreh disa paqartësi,shkelje;

1.Ky projektvendim citon bazën ligjore,është jashtë përcaktimeve ligjore, dhe shpreh përcaktimin , do shtyhet kontrata. Kontrata qysh prej vitit 2014. Nuk ka bashkëlidhur kontratën dhe për fat të keq nga paraqitja ligjore....

Nuk kemi një kontratë , pra do shtyjme kontratën, por nuk kemi një kontratë.

Zoti Endri është dhe propozues dhe anëtar i Bordit dhe, vjen sot si propozues për shtyrjen e afatit, kur është anëtar i Bordit.

Mungesa e kontratës e bën të cënueshme .

Atëherë, Bordi duhet që çdo 3 muaj, të kishte një informacion në lidhje me ecurinë e klubit..Dhe, thoshim duke ditur që ç’ ishte bërë, dhe vendosnim. Zoti Kushta do dëgjohet nga ana qytetare dhe bashkohem me mendimin e tij që, ky administrator ka deklaruar... E ndiej me shumë qytetari ta them në lidhje me etiketimet që thonë për këshilltarët..

Përsa i përket këtij projektvendimi, performanca e këtij klubi, si në aspektin ekonomik dhe atë sportiv, ka ulje, i ka borxh 2.2 milion euro,tatim fitimi, tatimi në burim, sigurime shoqërore.

Nuk e kuptoj që këto kompani janë në gjendje të paguajnë këto shuma deri në 25 milion euro.

E kam si pyetje. I thotë gjë kompania këtij zotërie “Arimo BV” në Hollandë?

“Flamurtari “ nuk ka si qëllim rritjen e performancës së tij, s’ka rezultate sportive ..

Dua të di, pse nuk ka mbërrit nga përfaqësuesi ynë, raporti 3-mujor, financiar ?

Pse duhet falenderuar ky zotëria , që është bërë dita - ditës gangren i futbollit? Fushat nuk kanë investime. Ka zgjedhur të financojë “Flamurtarin”, por nëqoftëse ai ,nuk është i kënaqur dhe, mund të tërhiqet. Jemi këtu, përfaqësues të qytetit dhe kemi bërë disa premtime.

Nuk di, nuk do Kryetari i bashkisë ta privatizojë, apo TRK Group +Atlas Global ?

Tatimet 2.5 milion, bllokohen.

Këto nuk kanë nevojë të mbyllen në llogari të dikujt. Kur hapet gjyqi, ekziston detyrimi ligjor. Privatizimi duhet të kishte përfunduar. Ju keni premtuar që, brenda vitit do ishte mbyllur procedura e privatizimit. Do ta votoj kundër .Nuk e meritojnë që të votohet ky projektvendim. Ky menaxhim për “Flamurtarin” ..Administratori dhe dy shoqëritë , do ta vënë bashkinë në një situatë të vështirë ligjore.

Z.Ervis Moçka – Çështja është dhe pasionale. U dëgjuan diskutimet që nga rezultatet deri tek politika. Jemi para faktit që “Flamurtari” duhet të rregjistrohet në lojrat e kampionatit. Nuk është lënë asnjëherë që të mbyllej, të privatizohet, por që, do fillonte procedura e privatizimit.

A ka vepruar administrata? Nga vjet u la detyrë, çfarë është bërë ?

Përgjigjja, ka filluar gjithë procedura. Ka filluar me prokurimet e shoqërive , është sjellë vlerësimi i aseteve ...Kjo procedurë po vazhdon, pra së shpejti do të vijë si “Oriku”.

Pra, në momentin që del në ankand, ka ofertues etj..Administrata, Drejtoria Juridike do ta lexojë, besoj i ka bërë të gjitha konstatimet . Në fund të fundit , është detyra e tyre për ta çuar deri në ankand. Ta inkurajojmë administratën të vazhdojë procedurat.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votë.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 3 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/5, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin për Shitjen me Ankand të Aksioneve të Klubit të Futbollit “K.F.Oriku”.

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi ka të bëjë me shitjen 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit “Oriku”.

Nga ana e bashkisë, kanë nisur procedurat e privatizimit. E keni dhe raportin financiar. Kemi të pranishëm dhe vlerësuesin.

Z.Arsen Belaj – Nuk jam në kundërshtim me këtë procedurë, të shitjes së aksioneve. Nuk jemi kundër, por thashë kontratat janë bërë, lojtarët kanë ardhur...Ngërçi, derisa të mbarojë ankandi, kush do ti paguajë futbollistët...Këta futbollistë derisa të mbarojë ankandi të paguhen nga bashkia, të nxirret një fond...Kush do ti paguajë..

Z.Dorian Demiri – Sot nuk jemi për të diskutuar për këtë.

Z.Arsen Belaj – Kush do ti paguajë? Sot është 100% e bashkisë. Ne kërkojmë që bashkia të nxjerrë një fond për ti paguar.

Z.Dorian Demiri – Do vlerësojmë të gjitha mundësitë. Nuk duam që ky klub të mbyllet.

Z.Ervis Moçka – I bashkëlidhem shqetësimit të zotit Belaj.. Nëqoftëse, nuk do subvecionohej, nuk duhej lidhur kontrata. Shpall falimentimin. Ka të drejtë zoti Arsen. Është mirë ta keni parasysh. Është 100% aksionere.

Z.Dorian Demiri – Do përpiqemi të gjejmë një zgjidhje.

Znj.Edlira Kapllanaj – Për të vazhduar aktivitetin këto klube, Klubi i Futbollit “Oriku” të vazhdojë në emër të atyre fëmijëve sportëdashës dhe, propozoj që për të vazhduar lojrat të sponsorizohen, ti kalohet një fond që ata të vazhdojnë aktivitetin.

Z.Muharrem Jazaj – Jam administrator i klubit. Në 3 vjet, nga bashkia kam marrë vetëm 5 milion lekë/reja. Kemi pritur shumë për ligjin, për sportin. Tani nuk mund ta sponsorizoj më. Derisa të bëhet privatizimi, le të vazhdohet të financohet.

Përveç ekipit, janë dhe disa grupe fëmijësh të moshave të ndryshme, që luajnë futboll.

Ka një fushë sporti, një stadium ..

Ne luajmë me shumë skuadra, të cilat finansohen 100% nga bashkitë. Duhet financuar sporti.

Në datën 1 gusht kemi bërë kërkesë për në Federatë. Duhet të bëni zgjidhje.

Z.Atird Hoxha – Do të thosha, përsa i përket procedurave, i është lënë kohë administratës dhe e ka bërë. Për financimin e Klubit të “Oriku”-t, zotëria që foli, do falenderuar së bahsku me kolegët e tjerë që kanë financuar, kur 100% është e bashkisë.

I them administratës, deri në përfundim të ankandit ,.. por me të drejtë,,si është vazhdimi i financimit , që nga ky moment, deri në momentin e ankandit , administrata të gjejë mundësinë që deri në konkludimin e saj , të financohet nga bashkia...Ose të vihet një pikë në këtë projektvendim, që të paguhet deri në konkludimin e ankandit.

E përgëzoj konkludimin e kësaj procedure, por duhet gjetur një zgjidhje , për kalimin e këtij ngërçi.

Z.Ermal Dredha – Asnjëherë , nuk jemi kundër mbështetjes financiare. Duam të brymosim brezin e ri ..Ka pas probleme në aspektin ligjor, do ndryshuar statusi. Po ja lë si detyrë Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Juridike dhe ju si skuadër, që të jemi në rregull nga ana ligjore dhe të gjejmë mundësi financimi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/6, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pikat 5,6,7,8 dhe projektvendimi shtesë, kanë të njëjtin objekt.

Z.Ervis Moçka - Kanë të njëjtin objekt pikat “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “, pra Pikat 6,8 dhe projektvendimi shtesë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe ASHK-së”. Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 3 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/7, datë 22.08.2024.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pikat 6,7 dhe projektvendimi shtesë”Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100....”

Z.Ervis Moçka – Si do ta zbardhësh vendimin ?

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Atëherë, pikat 6,8 dhe shtesa në një, ndërsa pika 7 , është ndryshim në VKB 92.

Në votim pika 6 , projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024”.

Votohet.

Pro – 32vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 3 vota

Miratohet.

Pra, votohen të tre projektvendimet në një .

Miratohen pikat 6,8, dhe shtesë. (Projektvendimi ”Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për Buxhetin e Bashkisë 2024”Për zgjerimin e sipërfaqes së varrezave të qytetit të Vlorës).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 10/8, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për një shtesë në VKB Nr 92, datë 24.11.2023” Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2024” i ndryshuar.

Votohet.

Pro – 32 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 3 vota
Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/9, datë 22.08.2024.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 9 e rendit të ditës, projektvendimi “Për normat e uniformave për Policinë Bashkiake”.

E hedhim në votim.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 3 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/10, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 10 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për miratimin e planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Bashkinë Vlorë”.

Është bërë dhe një dëgjese publike . Doni të refereoje drejtoresha ?

Znj.Aulona Veizi – Është bërë dhe një dëgjese publike . Në relacion janë të përmbledhura të gjitha, është sqaruar plani i përshtatjes klimatike, sidomos për profesionistët në këtë fushë. Jemi angazhaur me shumë ekspertë vendas dhe të huaj.Janë marrë 5 sektorë , të cilët janë më të prekshmit, nga këto ndryshime klimatike. ...Po vijnë këto efekte si në aspektin social e ekonomik. Edhe qyteti ynë është i prekur nga këto fasha pasi jemi qytet bregdetar . Kemi dalë me masa konkrete ndaj 5 sektorëve.

Z.Illir Aliaj – Një sqarim në lidhje me pikën 5, të transportit.

Znj.Aulona Veizi – Rreshjet e shumta ndikojnë , ka shumë problematika në transport. Çlirimi i dyoksidit të karbonit...Masat do të jenë. Pjesa e transportit urban të përmirësohet dhe të pakësohet ai individual.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/11, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 11 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënie titulli ”Qytetar Nderi i Vlorës”, Prof.Dok.Profit Canaj “.

Z.Illir Aliaj – Propozoj, që gjithë titujt e nderit, ti kaloni në një votim.

Z.Sokol Kushta – Doktor Profiti, doktori i të rinjve, Profesor në Institutin e Fiskulturës. Jam i nderuar që sot Vlora i jep këtë titull.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/12, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 12 e rendit të ditës, projektvendimi “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë“, Maliq Hadër Habilaj .

Votohet

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/13, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 13 e rendit të ditës, projektvendimi “Për vendosjen e bustit të Patriotit Ismail Mekati , në fshatin Drithas”.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/14, datë 22.08.2024.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 14 e rendit të ditës, projektvendimi “Për vendosjen e një pllake në territorin e Lagjes “Uji i Ftohtë” Vlorë”. (tek Rrapit dhe Çezma).

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Simo Petromilo – Me këtë rast dua të theksoj, në redaktimin e pllakës ...”Kontribut i zotit Vasil Velaj”.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Ta votojmë me këtë propozim?

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 10/15, datë 22.08.2024.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika “Të ndryshme “.

Z.Klodian Xhyheri – Para se të filloj me pikën “Të ndryshme “, e ngre në formën e sensibilizimit. I bëj thirrje Bashkisë Selenicë , në lidhje me një banor , Ilir Xhaferaj quhet, që është në gjendje të vështirë ekonomike dhe shëndetësore, kushte shumë të këqija. Nëse ka mundësi që, shoqatat që kanë lidhje me këto raste , deputetë, Bashkia Selenicë, u bëj thirrje për ndihmë., kërkon një karrocë me bateri, sa të mundemi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mendoj ta bëjmë, të kontribuojmë ne si këshill.

Znj.Liljana Breshani – Është Shoqata për Tetraplegjikët.

Z.Klodian Xhyheri – Në lidhje me Pallatin Nr 31,dikur Nr 428 në Rrugën “Zenel Gjoleka”, ka shumë probleme me amortizimin, me sigurimin e gjashtë familjeve . Nga insitucionet nuk kanë dalë me një raport teknik . Pallati është shumë i amortizuar, drejtoria përkatëse ta vlerësojë, të dalë me raport teknik ,ti jepet zgjidhje, përpara se të ndodhë ndonjë problem me jetë njerëzish..E para, të ngrenë një grup teknik.(Pallati ndoshet tek Ndërmarrja e Ujësjiellit)

Z.Klaudio Mehmetaj – Ndoshta i’ a referojmë Institutit të Ndërtimit.

Z.Klodian Xhyheri – Mjafton të gjejmë zgjidhje.

Z.Adrian Vreshtazi – Është problematikë që na ka ardhur nga Agjencia e Emergjencave Civile. Kemi shkuar. Ata kanë dhe probleme pronësie. Ne nuk disponojmë specialistë,por i kemi bërë kërkesë Institutit të Ndërtimit.

Z.Klodian Xhyheri – Boljerët në tarracat e pallateve..Të marrim teknikët dhe ta planifikojmë, ta diskutojmë, janë shumë problem tarracat e këtyre pallateve. Të fillojmë të mblidhemi me teknikët njëherë.

Z.Illir Aliaj – Meqenëse, sot kaloi projektvendimi për varrezat e qytetit, të shtohet një fond apo të ndiqet nga ndërmarrja, asfaltimi i rrugës në fund të varrezave, rreth 1.5 km, drejt fshatit Babicë e Vogël. Të rregullohet kjo rrugë.

Z.Atird Hoxha – Jam dakort me zotën Aliaj, është një vend ku shkojmë të gjithë, kemi të afërmit tanë. Është vetëm një rrugë që të çon atje. Kjo të marrë një prioritet , është vend që të vjen turp ta shikosh.Varrezat, janë të gjithë qytetit.

- Ka mbeturina. Koshat janë plot me mbetje në qytet (i kam me foto) Është problem të shtohen kapacitetet.

-Tek rreth rrotullimi, kalojnë në një rrugë plot mbetje, në Orikum.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Mendoj tu bëjmë thirrje dhe gjithë qytetarëve, të jenë më të kujdesshëm. Po punohet shumë, jemi në sezon.Unë mendoj që qytetarët e Vlorës të jenë më të kujdesshëm.

Z.Grigor Dede – Edhe për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Policinë Bashkiake, ishin dy projektvendime që erdhën. Jemi në sezon turistik, ngarkesa është shumë e madhe. Unë i nxis këto dy struktura të sjellin projektvendime sa më shpesh , kur kanë nevojë se, janë ata punonjës që punojnë me orar dhe pa orar. Të gjejmë mundësinë si ti ndihmojmë. Në lidhje me këtë po flas, jo t'ju kërkohet llogari. Të sensibilizohen qytetarët.

Z.Dorian Xhelili – Ndërmarrja e Shërbimeve Publike po punon. Në sezonin turistik po punojmë me kapacitete të shtuara dhe orare të zgjatura si në burime njerëzore, makineritë. Vlora në këtë sezon , kemi numër të madh turistësh dhe, kështu kemi rritje të mbetjeve. Kemi shtuar oraret. Jemi përpjekur dhe po punojmë. Mund të vini ti shikojmë, jetojmë të gjithë në këtë qytet. Ne po bëjmë maksimumin e mundshëm, përse i përket makinerive dhe burimeve njerëzore.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Është një shtyllë e energjisë së lartë që po ju bie familjeve tek ura, tek tyneli. I bëj thirrje OSHE-së, shkoni dhe e shikoni.

Z.Arsen Belaj – S'është vetëm në Vlorë sezoni. Në Orikum ka mbaruar kontrata, tenderi i pastrimit, problem shumë plehrat në Orikum.Janë ata të ndërmarrjes së pastrimit që e bëjnë.

-Ankesë nga një grup banorësh të një blloku pallatesh, ankesë nga përgjegjësja zonja Drita Troqe , është një rrugë ku janë bërë kanalizimet,.. nga këto shira rruga u bllokua.

Znj.Anisa Ceno – Jam një operatore turizmi.Qytetarët janë të pakujdesshëm , përse i përket hedhjes së mbeturinave. Kam parë që janë gjobitur operatorët që kanë hedhur mbetje jashtë koshave.Të aplikohet më shpesh nga policia bashkiake. Do sygjeroja :

-E para, një detyrim i hedhjes së mbetjeve në qeska të zeza, qytetarët dhe bizneset.

-Të vendosen koshat, jo në rrugë kryesore, por të jenë të aksesueshëm, është pjesa më sensitive.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Në lidhje me problematikën, keni numrin e policisë bashkiake të aksesueshëm.

Znj.Liljana Breshani – Në Plazhin e Vjetër, është një urë e cila është pa parrmakë anash.

Z.Klodian Xhyheri - Ankesë nga zonja Liri Balaj, në lagjen “24 Maji”, tek stacioni i trenit.Nuk ka gjetur zgjidhje me ujin e pijshëm, katër muaj pas shumë ankesave.

Znj.Evis Allushi – Pallati, ku ka qenë “Uji Vlora”, ka çarje të tubacioneve kryesore. Afër janë linjat elektrike , do të çojë në një katastrofë.

Kërkohet një koordinim midis OSHE dhe Ndërmarrjes së Ujësjetës .Ju lutem të gjendet një mekanizëm , të dërgohen dy ekipe nga të dy këto institucione.

-Jam banore e Rajonit Nr 3, pranë shkollës “Ali Demi “ është një gjendje që nuk i ka hije

gjimnazit , sheshi jashtë kangjellave ...Përse, ajo hapsirë mos të jetë pjesë e shkollës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është në proces gjyqësor.

Znj.Elca Bezhani – Është në proces gjyqësor.

Znj.Evis Allushi – E shoh si diçka emergjente .

Z.Klaudio Mehmetaj – Është tenderuar. U shpronësua, është hapsirë e bashkisë, jo e shkollës. Ka pas mbivendosje . Kjo hapsirë publike është e bashkisë, e kemi në proces tenderimi për lulishte.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse nuk keni gjë tjetër, faleminderit për ditën e sotme.

